

# Gjërat që e nxjerrin njeriun nga Islami

نواقض الإسلام

< Shqip – Albanian – ألباني >



Abdullah Ahmed El-Huvejl

عبد الله بن أحمد الحويل



Përktheu: Jusuf Kastrati

ترجمة: يوسف كاستراتي

## GJËRAT QË E NXJERRIN NJERIUN NGA ISLAMI

Gjërat që e nxjerrin njeriun nga feja islame janë të shumta, mirëpo dhjetë nga to janë më të shpeshta dhe më të rrezikshme. Ato janë:

### 1. Shirku në adhurim ndaj Allahut:

Këtu bën pjesë: therja e kurbanit për dikë tjetër përveç Allahut, siç bëjnë ata që therin kurban për xhinët dhe për varre.

Argument për këtë është thënia e Allahut:

﴿ إِنَّ اللَّهَ لَا يَغْفِرُ أَنْ يُشْرَكَ بِهِ وَيَغْفِرُ مَا دُونَ ذَلِكَ لِمَنْ يَشَاءُ ﴾

﴿Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush a diçka tjetër veç Atij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë.﴾<sup>1</sup>

2. Ai që merr ndërmjetës mes tij dhe Allahut, i lut ata, kërkon prej tyre ndërmjetësim ose u mbështetet atyre del nga Islami njëzëri.

3. Ai që nuk i konsideron mushrikët (politeistët) si jobesimtarë, dyshon në mosbesimin e tyre ose e konsideron besimin e tyre si të vërtetë del nga feja.

4. Ai që beson se ndonjë udhëzim pos udhëzimit të Muhammedit ﷺ është më i përsosur a beson se gjykimi i ndokujt tjetër është më i mirë se gjykimi i tij, siç bëjnë ata që parapëlqejnë gjykimet e tagutëve<sup>2</sup> ndaj gjykimit të Pejgamberit Muhamed ﷺ është kafir (jobesimtar).

5. Ai që urren diçka me të cilën ka ardhur i Dërguari i Allahut ﷺ bën kufër (del nga feja), edhe po qe se vepron sipas saj.

6. Ai që tallet me diçka që i takon fesë së Muhamedit ﷺ ose me shpërblimin a ndëshkimin e ndonjë vepre bën kufër (del nga feja).

Argument për këtë është thënia e Allahut:

<sup>1</sup> Sureja en-nisa, 116.

<sup>2</sup> Çdokush që adhurohet përveç Allahut dhe është i kënaqur me atë adhurim. Përkthyesi.

﴿ قُلْ أَلَيْسَ وَعَائِنَهُ وَرَسُولِهِ كُنْتُمْ تَسْتَهْزِئُونَ ﴿٦٥﴾ لَا تَعْتَذِرُوا فَدْ كَفَرْتُمْ بَعْدَ إِيمَانِكُمْ ﴾

﴿Thuj: “A mos vallë me Allahun, shpalljet dhe të Dërguarin e Tij po talleni?” Mos u shfajësoni! Ju e mohuat fenë, pasi patët besuar.﴾<sup>3</sup>

## 7. Magjia.

Në të bën pjesë shndërrimi nga dashuria në urrejtje dhe anasjelltas<sup>4</sup>. Andaj, kushdo që bën magji ose është i kënaqur me të del nga feja.

Argument për këtë është thënia e Allahut:

﴿ وَمَا يَعْلَمَانِ مِنْ أَحَدٍ حَتَّى يَقُولَا إِنَّمَا مَحْنُ فِتْنَةٍ فَلَا تَكْفُرْ ﴿٥١﴾ ﴾

﴿Këta engjëj nuk i mësonin ndokujt magji, pa i thënë: “Ne jemi dërguar për t’ju vënë në provë, andaj ti mos u bëj mohues (duke mësuar a duke ushtruar magjinë)!”﴾<sup>5</sup>

## 8. Përkrahja e jobesimtarëve kundër muslimanëve.

Argument për këtë është thënia e Allahut:

﴿ يَأَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا لَا تَتَّخِذُوا الْيَهُودَ وَالنَّصَارَىٰ أَوْلِيَاءَ بَعْضُهُمْ أَوْلِيَاءُ بَعْضٍ وَمَنْ يَتَوَلَّهُمْ فإِنَّهُ مِنْهُمْ إِنَّ اللَّهَ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الظَّالِمِينَ ﴿٥١﴾ ﴾

﴿O besimtarë! Mos i bëni miq e mbrojtës hebrenjtë dhe të krishterët! Ata janë mbrojtës të njëri-tjetrit. Kushdo prej jush që i bën ata miq, është me ata. Vërtet, Allahu nuk i udhëzon në rrugë të drejtë keqbërësit.﴾<sup>6</sup>

## 9. Ai që beson se ndokush mund të dalë jashtë suazave të shariatit të Muhamedit ﷺ është kafir (jobesimtar).

Argument për këtë është thënia e Allahut:

﴿ وَمَنْ يَبْتَغِ غَيْرَ الْإِسْلَامِ دِينًا فَلَنْ يُقْبَلَ مِنْهُ وَهُوَ فِي الْآخِرَةِ مِنَ الْخَاسِرِينَ ﴿٨٥﴾ ﴾

﴿Kush kërkon tjetër fe përveç Islamit, nuk do t’i pranohet dhe ai në botën tjetër do të jetë i humbur.﴾<sup>7</sup>

<sup>3</sup> Sureja et-teube, 65, 66.

<sup>4</sup> Duke bërë që burri që e do gruan e tij ta urrejë atë ose anasjelltas dhe burri që nuk e do gruan e tij ta dojë atë ose anasjelltas. Përkthyesi.

<sup>5</sup> Sureja el-bekare, 102.

<sup>6</sup> Sureja el-maide, 51.

<sup>7</sup> Sureja al-Imran, 85.

## 10. T'ia kthesh shpinën fesë së Allahut, duke mos e mësuar atë dhe duke mos punuar sipas saj.

Argument për këtë është thënia e Allahut:

﴿ وَمَنْ أَظْلَمُ مِمَّنْ ذُكِّرَ بِآيَاتِ رَبِّهِ ثُمَّ أَعْرَضَ عَنْهَا إِنَّا مِنَ الْمُجْرِمِينَ مُنْتَقِمُونَ ﴾

﴿Kush është më i padrejtë se ai që, kur i përmenden shpalljet e Zotit të tij, nuk ua vë veshin atyre? Vërtet, Ne do të hakmerremi ndaj keqbërësve!﴾<sup>8</sup>

### Vini re:

Në të gjitha këto vepra që e nxjerrin njeriu nga feja nuk ka dallim mes atij që i vepron ato qëllimisht, atij që i vepron duke bërë shaka ose atij që i bën nga frika, përveç atij që është i detyruar.

Këto janë nga veprat më të rrezikshme që e nxjerrin njeriun nga feja dhe njëkohësisht ndodhin më së shpeshti, andaj muslimani duhet të ruhet prej tyre dhe të ketë frikë nga rënia në to.

<sup>8</sup> Sureja es-sexhde, 22.

